

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbështetje të nenit 28 paragrafi 1.2, nenit 29 paragrafi 1, nenit 54 paragrafi 1.9, nenit 3 paragrafi 1.8, nenit 35 paragrafi 5, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229 (Gazeta Zyrtare nr.88/25), nenit 18 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-028 (Gazeta Zyrtare nr. 08/01), në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2016 mori në shqyrtim kërkesën e z. Visar Turkaj me nr. prot. 53/14-01 të datës 12.03.2014 për dhënien e pëlqimit për ujëra termominerale për N.P.H. Hotel “Kosova Park” në Banjë të Istogut dhe nxjerrë këtë:

KONKLuzion

1. Konstatohet se kërkesa e dorëzuar nuk është në kompetencën e Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës,
2. Komisioni konstaton se lënda me nr. të protokollit: 53/14-01 e datës 12.03.2014 merr epilogun sikur në pikën 1 të këtij dispozitivi dhe
3. Rasti konsiderohet i mbyllur.

ARSYETIM

Drejtori i N.P.H. Hotel “Kosova Park” në Banjë të Istogut z. Visar Turkaj, ka bërë kërkesën e regjistruar me nr. të prot. 53/14-01 me datë 12.03.2014, me të cilën kërkon pëlqimin që i bënë të mundur marrjen e lejes ujore nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, për pjesëmarrje në ujërat termominerale të Banjës së Istogut, me 1/3 e sasisë ose 5,5 lit/sek.

Kërkesa e tillë nuk është në kompetencën e Komisionit, por duhet t’i parashtrohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, për të marrë licencë konform Ligjit 04/L-147 për Ujërat e Kosovës.

Kjo kërkesë është parashtruar më 12.03.2014, mirëpo në atë kohë Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk e kishte Komisionin funksional dhe rrjedhimisht ka qenë e pamundur të marrë ndonjë veprim ligjor lidhur me këtë çështje.

Rasti si i tillë nuk është në kompetencë të Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe merr epilogun si në dispozitiv të këtij **KONKLuzioni**.

Këshilla juridike:

Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicioj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- *Arkiva dhe*

- *N.P.H. Hotel "Kosova Park", Banjë e Istogut*


**KOMISIONI I
AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS**




Valon Prestreshi
Kryetar



Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar




Fatime Haziri
Anëtare



Muhamed Krasniqi
Anëtar





Shaqir Morina
Anëtar